



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.637/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Kymete Kicaj dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtare, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Skenderajt, të paraqitur kundër subjektit politik Lista e Pavarur - Bekim Jashari, me seli në Komunën e Skenderajt, me objekt të çështjes, thyerja e heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.10.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHEN** të bazuara ankesat e evidentuara me numra: Anr.637/2021, Anr.638/2021, Anr.639/2021, Anr.640/2021, Anr.641/2021 dhe Anr.642/2021 të gjitha të datës 17.10.2021, të paraqitura nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Skenderajt, ndërsa subjektit politik Lista e Pavarur-Bekim Jashari, me seli në Komunë e Skenderajt, i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 1,800.00 euro (një mijë e tetëqind), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e thyerjes së heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale, për zgjedhjet lokale të datës 17.10.2021.

**II. DETYROHET** subjekti politik Lista e Pavarur-Bekim Jashari, me seli në Komunën e Skenderajt, që gjobën e shqiptuar si në pikën **-I-** të dispozitivit të këtij vendimi ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të dënimit shtesë.

## A r s y e t i m

Më datë 17.10.2021, PZAP-i ka pranuar ankesat Anr.637/2021, Anr.638/2021, Anr.639/2021, Anr.640/2021, Anr.641/2021 dhe Anr.642/2021 të gjitha të datës 17.10.2021, të paraqitura nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës kundër subjektit politik Lista e Pavarur-Bekim Jashari në të cilat pretendon se kandidatë për asamble komunale në komunën e

Skenderajt si dhe aktivistë të këtij subjekti konkretisht kandidatja për asamble komunale në Komunën e Skenderajt Alketa Mecini, aktivistët Hajdar Beka, Arben Mehmeti, Gëzim Gashi, Shekip Fazliu, dhe Ramiz Shala kanë bërë postime dhe shpërndarjen e materialeve zgjedhore në rrjetin social në Facebook, në të cilin shihen qartë numri subjektit politik Lista e Pavarur-Bekim Jashari dhe të vetë kandidatëve, të cilët në ditën e heshtjes zgjedhore kanë reklamuar materialet nxitëse elektorale duke bërë thirrje për të votuar kandidatin për kryetar të Komunës së Skenderajt Bekim Jasharin si dhe kandidaten për asamble në komunën e Skenderajt nga ky subjekt politik Alketa Mecini. Në mbështetje të pretendimeve të tyre subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës krahas ankesave ka bashkangjitur si dëshmi fotografi të printuara të shkeljeve të supozuara sipas ankesave.

Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme përkatësisht neni 52 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provave materiale.

PZAP, më datë 17.10.2021 i ka paraqitur Listës së Pavarur-Bekim Jashari kërkesë për përgjigje lidhur me ankesat Anr.637/2021, Anr.638/2021, Anr.639/2021, Anr.640/2021, Anr.641/2021 dhe Anr.642/2021 me të cilën ka kërkuar që të përgjigjet deri më datë 18.10.2021 në ora 12:00.

Subjekti politik Lista e Pavarur- Bekim Jashari më datë 18.10.2021 ka paraqitur pranë PZAP-së përgjigje në ankesë sa i përket ankesave të parashtruara Anr.637/2021, Anr.638/2021, Anr.639/2021, Anr.640/2021, Anr.641/2021 dhe Anr.642/2021 të gjitha të datës 17.10.2021, duke i kundërshtuar si të pabaza ngase sipas këtij subjekti lidhur me ankesën Anr.637/2021 për mosrespektim të heshtjes parazgjedhore nga kandidatja Alketa Mecini e njëjta nuk ka bërë asnjë publikim në rrjetin social facebook pas fillimit të heshtjes parazgjedhore por kandidatja në fjalë nga angazhimi i saj në teren ka harruar që ta ndalë sponzorizimin e postimit të saj të mëhershëm dhe kështu iu është shfaqur qytetarëve në facebook. Sa i përket ankesës Anr.639/2021 subjekti politik Lista e Pavarur- Bekim Jashari thekson se personi i referuar në këtë ankesë konkretisht drejtori për kulturë, rini dhe sport në komunën e Skenderajt Arben Mehmeti ka shpërndarë një video me fjalim të Rifat Jasharit, fjalim ky i cili nuk përmban asnjë mesazh politik që bie ndesh me heshtjen parazgjedhore.

Më tej në përgjigje thuhet se sa i përket ankesës Anr.642/2021 aktivisti Ramiz Shala nga subjekti politik Lista e Pavarur- Bekim Jashari nuk ka qenë i angazhuar në fushatën elektorale dhe kështu postimi i tij nuk është me dijeninë e shtabit zgjedhor të këtij subjekti.

Ndërsa sa i përket ankesave Anr.638/2021 dhe Anr.641/2021 personat e referuar në këto ankesa nuk kanë lidhje me subjektin politik Lista e Pavarur- Bekim Jashari, nuk mbajnë asnjë pozitë dhe nuk janë anëtarë të këtij subjekti andaj edhe adresimi i ankesës sipas këtij subjekti është i gabuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale – fotografive, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesat janë të bazuara**

Paneli, pas vlerësimit të pretendimeve në ankesa Anr.637/2021, Anr.638/2021, Anr.639/2021, Anr.640/2021, Anr.641/2021 dhe Anr.642/2021 të gjitha të datës 17.10.2021, të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta dhe të gjitha ankesat janë paraqitur nga subjekti politik PDK, po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik Lista e Pavarur-Bekim Jashari, prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga shkresat e lëndës shihet se subjekti politik Lista e Pavarur-Bekim Jashari, kandidatë për asamble Komunale në Komunën e Skenderajt dhe aktivist të këtij subjekti, gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin social “Facebook” kanë bërë fushatë zgjedhore dhe kanë udhëzuar që të votohet subjekti politik Lista e Pavarur-Bekim Jashari, konkretisht kandidati për kryetar komune në Skenderaj nga radhët e këtij subjekti,, dhe kandidatja Alketa Mecini të apostrofuuar në ankesë ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmoi hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara duke hasur në gjithsej 6 shkelje për faktin se në llogarinë e Facebook-ut, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës për postimin e kandidatës për asamble dhe aktivistëve të Listës së Pavarur- Bekim Jashari, Alketa Mecini, Hajdar Beka, Arben Mehmeti, Gëzim Gashi, Shekip Fazliu, dhe Ramiz Shala, në ditën e heshtjes zgjedhore, katër nga këto postime janë bërë më datë 16.10.2021 dhe 17.10.2021 dhe në kohën e verifikuar nga PZAP, kanë qenë ende aktive dhe të shfaqura, që në këtë mënyrë kanë thyer heshtjen zgjedhore.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Lista e Pavarur-Bekim Jashari se ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës është e pabazuar ngase kandidatja për

asamble komunale në komunën e Skenderajt Alketa Mecini nuk ka bërë asnjë publikim në rrjetin social facebook pas fillimit të heshtjes parazgjedhore por kandidatja në fjalë nga anagzhimi i saj në teren ka harruar që ta ndalë sponzorizimin e postimit të saj të mëhershëm dhe kështu iu është shfaqur qytetarëve në facebook, Paneli i vlerësoi si të pabazuara ngase me dispozita ligjore, subjekteve politike apo kandidatëve të tyre iu ndalohet të bëjnë fushatë, në një mënyrë apo tjetër 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit, andaj në këtë rast është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore dhe një fakt i tillë nuk e arsyeton shkeljen ligjore të kandidatës në fjalë.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Lista e Pavarur-Bekim Jashari se ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës është e pabazuar ngase drejtori për kulturë, rini dhe sport në komunën e Skenderajt Arben Mehmeti ka shpërndarë një video me fjalim të Rifat Jashari, fjalim ky i cili nuk përmban asnjë mesazh politik që bie ndesh me heshtjen parazgjedhore, Paneli i vlerësoi si të pabazuara ngase me dispozita ligjore ky veprim bie ndesh me nenin 36 pika b) të LZP-së, dhe se nga fotot e ofruara si dëshmi të paraqitura në ankesë krahas postimit që është shpërndarë në rrjetin social facebook nga Arben Mehmeti shihet qartë në prapavijën e fjalimit thirrja për të votuar kandidatin Bekim Jashari, për kryetar komune të Skenderajt nga Lista e Pavarur- Bekim Jashari.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Lista e Pavarur-Bekim Jashari se ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, është e pabazuar, ngase aktivisti Ramiz Shala nga subjekti politik Lista e Pavarur- Bekim Jashari nuk ka qenë i angazhuar në fushatën elektorale dhe kështu postimi i tij nuk është me dijeninë e shtabit zgjedhor të këtij subjekti dhe se këto ankesa për Hajdar Bekën dhe Shekip Fazli, janë të pabazuara edhe për faktin se të njëjtit nuk kanë lidhje me subjektin politik Lista e Pavarur- Bekim Jashari, nuk mbajnë asnjë pozitë dhe nuk janë anëtarë të këtij subjekti andaj edhe adresimi i ankesës sipas këtij subjekti është i gabuar, Paneli i vlerësoi si të pabazuara këto pretendime, sepse postimet kanë qenë për kandidatët e subjektit politik Lista e Pavarur- Bekim Jashari dhe se të njëjtat postime janë bërë nga përkrahës të kësaj partie dhe si e tillë konsiderohet se është bërë shkelje e heshtjes zgjedhore prandaj edhe ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës janë pranuar si të bazuara.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Andaj Paneli, duke iu referuar të cekurave më lart dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së, konstaton se subjekti politik Lista e Pavarur-Bekim Jashari është përgjegjëse për

veprimet e tije, pasi që me veprimet e lartë cekura ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, e cila dispozitë ligjore që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se “24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, gjithashtu si rrethanë paneli mori faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba Lista e Pavarur-Bekim Jashari, nuk ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme dhe nuk ka marrë mjete financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore si dhe faktin se subjekti në fjalë ka marrë pjesë në zgjedhje vetëm në një Komunë të Republikës së Kosovës, të cilat rrethana kanë ndikuar në lehtësimin e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi, nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekura në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.637/2021 më datë 18.10.2021



**Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.**